



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË KURBIN

Nr. _____ Prot.

Laç, më 16.05.2019

N J O F T I M

**PËR FILLIMIN E PROÇEDURËS SË KONKURIMIT PËR ËMËRIMIN NË
POZICIONIN E PUNËS KOORDINATOR**

Bazuar në ligjin nr 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe urdhërit nr 27 date 21.02.2019 të Prokurorit të Përgjithshëm për “Strukturën organike të Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kurbin”, me qëllim plotësimin e vendeve vakante që ekzistojnë në strukturën e institucionit në pozicionin 1 (nje) Koordinator, Prokuroria Prane Gjykates se Shkalles se Pare Kurbin:

N J O F T O N

1. Fillimin e proçedurës për konkurim të hapur të kandidateve për pozicionin **Koordinator**, pranë Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kurbin.

2. Referuar neneve 68,74,75,76, te ligjit nr 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, **kandidatët e interesuar për konkurim**, përveç kushteve të përgjithshme për tu pranuar në shërbimin civil, duhet të plotësojnë dhe kriteret e veçanta si me poshte:

Arsimi, trajnimi dhe eksperienca:

Kriteret e nevojshme.

Të jetë shtetas shqiptar.

Të ketë zotësi të plotë për të vepruar.

Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo kundërvajtjeje penale me dashje, ose ndaj tij të mos ketë një hetim penal në proçes;

Të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga puna ose ndonjë masë tjetër disiplinore, e cila është ende në fuqi, sipas legjislacionit, në momentin e konkurimit.

Të ketë përfunduar ciklin e dytë të studimeve universitare për psikologji, sociologji, ose fusha të tjera të ngjashme.

Të ketë aftësi për të krijuar marrëdhënie pune efektive me stafin e prokurorisë, ofruesit e shërbimeve, që operojnë në komunitet, viktimat dhe publikun.

Të ketë aftësi për të ndërvepruar në mënyrë efektive dhe me takt me viktimat emocionalisht të shqetësuara.

Të ruajë sekretin hetimor.

Të ruajë konfidencialitetin e informacionit të viktimës.

Të ketë integritet dhe cilësi të larta morale.

Të marrë pjesë në trajnime të vazhdueshme në lidhje me viktimat e krimit.

Të ketë njohuri të mira kompjuterike të tilla si: Microsoft Word, Excel, Power Point, etj.

Kritere të preferuara, por jo të nevojshme:

Njohja e shërbimeve që u ofrohen viktimave të krimit nga ofrues të ndryshëm shtetërorë dhe jo qeveritarë.

Njohja e sistemit të drejtësisë penale dhe procedurave gjyqësore.

3.Kandidatët për pozicionin e lirë të punës “Koordinator” duhet të paraqesin dokumentacionin e mëposhtëm:

- a.Kërkesë me shkrim,
- b.Kopje të dokumentit të identifikimit,
- c.Curriculum Vitae,
- d.Diplomë universitare të nivelit 3+2 dhe listë notash (*të noterizuara*).
- e.Dokument që verteton praktiken profesionale.
- f.Dëshmi kualifikimi apo specializimesh (*nëse ka*),
- g.Vlerësime të punës nga punëdhënësi të mëparshëm,
- h.Vërtetim për gjendjen gjyqësore,
- i.Raport mjeko-ligjor,
- j.Çertifikatë të gjuhës së huaj (*nëse ka*).
- k.Dëshmi kompjuteri.

4. Kërkesa sëbashku me dokumentacionin e kandidatit, të paraqitet brenda datës 27.05.2019 në K/Sekretarinë e Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kurbin.

**KOMISIONI I PRANIMIT PËR PROÇEDURAT E PUNËSIMIT NE PROKURORINË
PRANË GJYKATES SË RRETHIT GJYQËSOR KURBIN**